

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 45022/16

FOTAQ ZAHARIA KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 9 nëntor 2021 si Komision, i përbërë nga:

María Elósegui, *kryetare*,

Darian Pavli,

Frédéric Krenc,

dhe Olga Chernishova, *zëvendësregjistrare e Seksionit*,

Pasi morën në konsideratë kërkesën e mësipërme të paraqitur më 30 korrik 2016,

Duke marrë në konsideratë deklaratën e paraqitur nga Qeveria e paditur, më 12 maj 2021, në të cilën Gjykatës i kërkohej të hiqte kërkesën nga lista e çështjeve, si edhe përgjigjen e kërkuarit për atë deklaratë,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

1. Kërkuari, z. Fotaq Zaharia, është një shtetas shqiptar, i cili ka lindur në vitin 1960 dhe po vuan një dënim me burgim. Ai u përfaqësua përpara Gjykatës nga znj. E. Skendaj, një avokate e cila e ushtron veprimtarinë e saj në Tiranë, dhe punon për Komitetin Shqiptar të Helsinkit.

2. Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga agjentët e saj të asaj periudhe, znj. A. Hicka, znj. E. Muçaj dhe, në vijim, nga znj. B. Lilo nga Avokatura e Shtetit.

3. Kërkuari u arrestua në vitin 2009. Gjatë arrestimit, ai mori një plagë në kofshën e majtë si pasojë e një të shtëne me armë, çka i shkaktoi një frakturë në kockë dhe paaftësi të përhershme. Ai iu nënshtrua një ndërhyrje kirurgjikale për të rregulluar kockën e thyer me një pllakë dhe vida. Procedimet penale të ndërmarra ndaj kërkuarit çuan në dënimin e tij dhe në dhënien e një dënimi të gjatë me burgim, elemente të cilat nuk janë lënda e kësaj kërkesë. Në vitin 2013, ai u transferua për ta vuajtur dënimin e tij në burgun e sigurisë së lartë Krujë.

4. Pavarësisht ndërhyrjes fillestare mjekësore, shëndeti i kërkuarit u përkeqësua, si rezultat – midis të tjerash – i mosshërimit të frakturës, së cilës iu shtua edhe një infeksion në kockë, sidomos pasi ai ishte rrëzuar, duke dëmtuar pllakën dhe vidat, gjë e cila kishte shkaktuar mpiksje të gjakut, dëmtim të nervave shiatic dhe femoral (nervi i femurit), reduktim të artikulacionit koksofemoral si edhe ndryshime trofike në paraqitjen e jashtme të këmbës së tij. Në vitin 2011, sipas një raporti mjekësor të ekspertëve rekomandohej që kërkuari t'i nënshtrohej një ndërhyrjeje tjetër kirurgjikale për riparimin e pllakës, realizimi i së cilës kërkonte të siguroheshin gjashtë pajisje specifike mjekësore. Deri në vitin 2014, autoritetet kishin siguruar vetëm dy nga gjashtë pajisjet, ndërsa pjesa tjetër nuk gjendej as në spitalet publike dhe as në ato private, dhe as tek distributorët farmaceutikë në vend.

5. Më 10 mars 2015, Gjykata e Rrethit Krujë, duke marrë në konsideratë përkeqësimin e shëndetit të kërkuarit, dhe pasi mori opinionin e dy ekspertëve mjekësorë, konstatoi se kërkuari kishte qenë objekt i një trajtimi çnjerëzor dhe degradues në shkelje të nenit 3 të Konventës. Kushtet e burgimit kishin ndikuar negativisht dhe kishin përkeqësuar gjendjen e tij shëndetësore. Gjykata i urdhëroi autoritetet ta ndërprisnin atë trajtim dhe të merrnin masat e nevojshme për të siguruar një ndërhyrje mjekësore në Qendrën Spitalore Universitare të Traumës në Tiranë.

6. Më 25 gusht 2016, Gjykata, në mbështetje të rregullit 39 të Rregullores së Gjykatës, vendosi t'i sugjeronte Qeverisë se kërkuesit i duhej ofruar në mënyrë të menjëhershme ndërhyrja e nevojshme mjekësore sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Krujë.

7. Më 30 dhjetor 2016, Gjykata Kushtetuese vendosi se e drejta e kërkuesit për akses në gjykatë ishte shkelur, për shkak të moszbatimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Krujë. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese nënvizoi se në vitin 2015 dhe 2016, doktorët i kishin bërë me dije kërkuesit se për shkak të natyrës së komplikuar të ndërhyrjes kirurgjikale dhe nevojës për një sërë pajisjesh mjekësore të nevojshme për realizimin e ndërhyrjes, disa prej problemeve të tij shëndetësore mund të vijonin edhe pas ndërhyrjes kirurgjikale, dhe për pasojë, i kishin paraqitur alternativa të ndryshme. Kërkuesi nuk kishte pranuar t'i nënshtrohej ndërhyrjes mjekësore, nëse doktorët nuk i jepnin siguri të plotë se ndërhyrja do të ishte e suksesshme, dhe të siguronin të gjitha pajisjet mjekësore të përshkruara në ekspertizën e vitit 2011.

8. Qeveria ishte njoftuar për kërkesën në përputhje me nenet 3, 6, 13 dhe 14 të Konventës.

LIGJI

9. Në mbështetje të nenit 3, midis neneve të tjera, kërkuesi pretendonte se autoritetet nuk i kishin ofruar trajtimin e duhur mjekësor. Ai u ankua edhe për një shkelje të nenit 6 të Konventës për shkak të moszbatimit nga ana e autoriteteve të vendimit të Gjykatës së Rrethit Krujë.

10. Pas dështimit të përpjekjeve për të arritur një zgjidhje miqësore, më 12 maj 2021, Gjykata mori një deklaratë të njëanshme nga Qeveria, në të cilën thuhej si më poshtë:

“Qeveria, me anë të deklaratës së saj së njëanshme, shpreh keqardhjen e saj që kërkuesi ka qenë objekt i trajtimit çnjerëzor dhe degradues, në shkelje të nenit 3 të Konventës, sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Krujë (...), i cili u la në fuqi edhe nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese... Në lidhje me këtë situatë, vendimi i Gjykatës së Rrethit Krujë i kërkonte autoriteteve t'i garantonin kërkuesit ndihmën e duhur mjekësore dhe ta ndërprisnin këtë trajtim çnjerëzor dhe degradues si rezultat i mosofrimit të kësaj ndihme.

Për shkak se kishte kaluar një kohë e gjatë që nga rekomandimi i dhënë në raportin e ekspertizës mjekësore... në vitin 2011, për kryerjen e një ndërhyrjeje komplekse kirurgjikale, autoritetet marrin përsipër që kërkuesi të vizitohet nga një ekip specialistësh, brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës për këtë çështje, për të: 1) vlerësuar gjendjen e tij aktuale shëndetësore; dhe 2) për të rekomanduar, sipas njohurive të tyre, ndërhyrjet kirurgjikale të cilat mund të përmirësonin kushtet e tij shëndetësore. Në mbështetje të ligjit dhe procedurave të brendshme, kërkuesit do t'i ofrohej mundësia për të caktuar një doktor me zgjedhjen e tij që t'i bashkohej ekipit të doktorëve [specialistë].

Autoritetet marrin përsipër të informojnë kërkuesin, pa vonesa, për çdo rekomandim dhe përfundim që do të arrihej nga ekipi i mjekëve specialistë, si edhe t'i përgjigjen të gjitha pyetjeve të tij për linjën e propozuar të veprimeve, në mënyrë që t'i bënin të mundur që të merrte një vendim pasi të ishte i mirinformuar për ndërhyrjet më të përshtatshme.

Përveç garantimit të prokurimit për çdo mjekim dhe/ose pajisje mjekësore, si edhe pëlqimin me shkrim të kërkuesit për çdo ndërhyrje mjekësore, autoritetet marrin përsipër të venë në zbatim brenda tre muajve nga momenti kur ndodhën zhvillimet e mësipërme, rekomandimet që do të jepen nga ekipi i doktorëve specialistë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, kryerjen e ndërhyrjes(ve) kirurgjikale në Qendrën Spitalore Universitare të Traumës, apo në një spital tjetër ekuivalent civil shtetëror, me të njëjtat kushte që këto ndërhyrje mjekësore i vihen në dispozicion edhe publikut të gjerë, dhe mbulohen nga sistemi publik i kujdesit shëndetësor shqiptar. Në këtë aspekt, Qeveria vëren se në harkun kohor nga viti 2015 deri në vitin 2020, në Qendrën Spitalore Universitare të Traumës u kryen 36 ndërhyrje kirurgjikale me të njëjtën diagnozë si ajo e kërkuesit.

Autoritetet marrin përsipër t'i sigurojnë kërkuesit terapitë pas operacionit sipas rekomandimeve që mund të jepen nga doktorët specialistë me të njëjtat kushte si terapitë pas operacionit që i ofrohen publikut të gjerë dhe që mbulohen nga sistemi shqiptar publik i kujdesit shëndetësor.

Autoritetet marrin përsipër të garantojnë akses për kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij ligjor në dosjen mjekësore sipas ligjit dhe procedurave të brendshme.

Qeveria deklaroi se ishte përgatitur të paguante 13000 euro (trembëdhjetë mijë euro) për të mbuluar të gjitha dëmet monetare dhe jo monetare, si edhe 2000 euro (dy mijë euro) për të mbuluar të gjitha kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesit.

Shumat e sipërpërmendura do të konvertohen në monedhën lokale në normën e zbatueshme në datën e pagesës dhe nuk do t'i nënshtrohen taksave që mund të jenë të zbatueshme. Ato do të paguheshin brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të marrë nga Gjykata për ta hequr çështjen nga lista e saj me çështje. Në rast se këto shuma nuk do të paguheshin brenda periudhës tremujore, Qeveria merr përsipër të paguajë një interes të thjeshtë për to, nga përfundimi i asaj periudhe deri në zgjidhje, sipas një norme të barabartë me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së vonës së pagesave, plus tre pikë përqindje.”

11. Me anë të një shkrese të datës 14 qershor 2021, kërkuesi parashittoi se raportin e ekspertizës mjekësore i vitit 2011 rekomandonte kryerjen e ndërhyrjes mjekësore pas sigurimit të gjashtë pajisjeve mjekësore. Mossigurimi nga ana e autoriteteve i të gjithë setit të pajisjeve mjekësore, pa ofruar asnjë informacion për këtë fakt, konstatohet të vinte si shkelje e të drejtave të tij garantuar sipas vendimit dhënë nga ana e Gjykatës së Rrethit Krujë, dhe i lënë në fuqi nga Gjykata Kushtetuese. Premtimet e paraqitura në deklaratën njëanëshe ngrinin shqetësime serioze për kërkuesin, për faktin se ai mund të gjendej në kushte më pak favorizuese ose jofavorizuese në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore, duke qenë se doktorët kishin rekomanduar më herët që ai t'i nënshtrohej një ndërhyrjeje kirurgjikale. Autoritetet nuk ia kishin dalë të përmbushnin detyrimin e tyre për t'i ofruar kërkuesit ndërhyrjen mjekësore, duke përfshirë edhe trajtimin terapeutik, në dhjetë vitet e fundit. Së fundmi, ai shprehu dëshirën t'i nënshtrohej ndërhyrjes kirurgjikale nëse autoritetet i siguronin të gjitha pajisjet mjekësore të parashikuara në raportin e ekspertizës mjekësore të vitit 2011, dhe bëri edhe një konsultë me të njëjtët doktorë të cilët e kishin vizituar në vitin 2011.

12. Gjykata thekson se neni 37 i Konventës parashikon se ajo mund të vendosë në çdo fazë të procedimeve ta heqë kërkesën nga lista e saj e çështjeve, në rastet kur rrethanat çojnë në një nga përfundimet e parashikuara në pikën “a”, “b” ose “c”, të paragrafit 1 të atij neni. Neni 37§1 (c) i mundëson Gjykatës ta heqë një çështje nga lista e saj nëse “për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës”.

13. Gjithashtu, Gjykata thekson se në rrethana të caktuara, ajo mund ta heqë një kërkesë sipas nenit 37§1 (c) në mbështetje të një deklarate njëanëshe nga një Qeveri e paditur, edhe nëse kërkuesi dëshiron që shqyrtimi të vijojë. Në këtë pikë, Gjykata do ta shqyrtojë deklaratën në mbështetje të parimeve që dalin sipas praktikës së saj gjyqësore, veçanërisht në vendimin *Tahsir Acar (Tahsin Acar kundër Turqisë)* (objeksionet paraprake) [DHM], nr. 26307/95, §§ 75-77, GJEDNJ 2003-VI; *WAZA Sp. z.o.o. kundër Polonisë* (vendim), nr. 11602/02, 26 qershor 2007; dhe *Sulwińska kundër Polonisë* (vendim), nr. 28953/03, 18 shtator 2007).

14. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se lënda e kërkesës ka të bëjë me detyrimin e Shtetit që t'i garantojë kërkuesit trajtimin e duhur mjekësor, si edhe të respektojë vendimin e brendshëm të formës së prerë, i cili ka njohur mungesën e një trajtimi të tillë mjekësor, dhe ka urdhëruar kryerjen e ndërhyrjes mjekësore. Në lidhje me këtë gjë, Gjykata shqyrtoi çështje të mëparshme që kanë të bëjnë me trajtimin e papërshtatshëm mjekësor që i ofrohet të burgosurve, ose të paraburgosurve, dhe kushtet e këqija në burgim (shih për shembull *Kudła kundër Polonisë* [DHM], nr. 30210/96, §94, GJEDNJ 2000-XI; *Dybeku kundër Shqipërisë*, nr. 41153/06, §38, 18 dhjetor 2007;

Groni kundër Shqipërisë, nr. 25336/04, §127, 7 korrik 2009; *Cara-Damiani kundër Italisë*, nr. 2447/05, §66, 7 shkurt 2012; dhe *Blokhin kundër Rusisë* [DHM], nr. 47152/06, §136, 23 mars 2016).

15. Gjykata gjykon se deklarata njëanëshe përmban pranimin nga ana e Qeverisë të faktit se kërkuuesi i është nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe degradues në shkellje të nenit 3, edhe pse gjykatat e brendshme e kishin bërë këtë konstatim eksplicit dhe kishin urdhëruar një ndërhyrje mjekësore për kërkuuesin në Qendrën Spitalore Universitare të Traumës, Tiranë.

16. Gjithashtu, Gjykata vëren edhe natyrën dhe shtrirjen e premtimeve të Qeverisë, dhe mirëpret afatet kohore për realizimin e këtyre premtimeve. Në rrethanat konkrete të çështjes në fjalë, Gjykata e justifikon faktin që kërkuuesi të përfitojë një trajtim të ri mjekësor përpara se t'i nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjikale – e cila, sipas këndvështrimit të doktorëve specialistë, deklaruar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, do të jetë një ndërhyrje e komplikuar – për të vlerësuar gjendjen e tij aktuale shëndetësore, edhe për faktin se kanë kaluar 10 vjet që nga momenti kur është kryer ekzaminimi mjekësor në vitin 2011.

17. Nuk i takon Gjykatës që të spekulojë për cilësinë e rezultatit të kontrollit mjekësor në të ardhmen. Për këtë arsye, Gjykata e gjen të pa mbështetur në fakte frikën dhe dyshimet e kërkuessit për rezultatit të kontrollit mjekësor. Gjykata gjykon se në lidhje me deklaratën njëanëshe, qëllimi i këtij premtimi është garantojë respektimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Krujë, sipas së cilit Gjykata Kushtetuese konstatoi se është shkelur e drejta e kërkuessit për të pasur akses në gjykatë, siç garantohet edhe nga neni 6 i Konventës. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata gjykon se për shkak të natyrës së komplikuar të ndërhyrjes kirurgjikale dhe variableve të ndryshme, nuk është e paarsyeshme që autoritetet nuk janë në pozicionin për të ofruar siguri absolute se ndërhyrja mjekësore do të jetë plotësisht e suksesshme. Në çdo rast, Gjykata është e kënaqur me faktin se autoritetet kanë propozuar një shumë kompensimi, e cila është në përputhje me shumën e dhëna në çështje të tjera të ngjashme (shih për shembull vendimin *Groni*, cituar më sipër; *Strazimiri kundër Shqipërisë*, nr. 34602/16, 21 janar 2020) për të gjithë dëmin që i është shkaktuar kërkuessit. Qeveria është angazhuar që të paguajë shumën brenda tre muajve nga vendimi i Gjykatës, me një interes për pagesën e papaguar, për shkak të pagesës së vonuar.

18. Gjithashtu, Gjykata është e kënaqur se pavarësisht se kërkuessit po vuan një dënim me burgim, të gjitha trajtimet dhe ndërhyrjet, duke përfshirë terapinë postoperacionit, do të ofrohen në të njëjtin standard me trajtimet dhe ndërhyrjet që i ofrohen publikut të gjerë, dhe mbulohen nga sistemi publik i kujdesit shëndetësor.

19. Gjykata vlerëson se është e rëndësishme që të theksohet se procedura e deklaratës njëanëshe është një rast përjashtimor. Si i tillë, për sa u përket shkelljeve të të drejtave më themelore të përfshira në Konventë, nuk synohet që të anashkalohet kundërshtimi i kërkuessit për një zgjidhje miqësore, ose që të lejohet Qeveria që të mos mbajë përgjegjësi për këto shkellje (shih *Taşdemir dhe të tjerët kundër Turqisë* (vendim), nr. 52538/09, §21, 18 shtator 2019). Në kërkesën në fjalë, Gjykata ka shqyrtuar rrethanat e çështjes dhe përmbajtjen e deklaratës njëanëshe sipas praktikës së saj gjyqësore. Për këtë arsye, mendohet se nuk është e justifikueshme të vijohet më tej me shqyrtimin e kërkesës (neni 37§1 (c)).

20. Gjithashtu, sipas të gjitha konstatimeve të sipërpërmendura, dhe veçanërisht në mbështetje të praktikës gjyqësore të ngjashme të mëparshme për lëndën në fjalë, Gjykata është e kënaqur se për sa ka të bëjë me të drejtat e njeriut, sipas parashikimit në Konventë dhe protokollet e saj, nuk kërkohet që të vijohet me shqyrtimin e kërkesës (neni 37§1 *in fine*).

21. Në vijim, Gjykata vëren se kërkuessit është ankuar në mbështetje të neneve 13 dhe 14 të Konventës, të cilët nuk u adresuan në mënyrë eksplicite nga Qeveria në deklaratën e saj njëanëshe. Megjithatë, Gjykata gjykon se këto ankesa nuk meritojnë një shqyrtim të veçantë duke qenë se ato përfshihen në mënyrë implicite në premtimet që gjenden në deklaratën njëanëshe të Qeverisë.

22. Së fundmi, Gjykata thekson se, në rast se Qeveria nuk respekton kushtet e deklaratës së saj njëanëshe, kërkesa do të rikthehet në listën e çështjeve në respektim të nenit 37§2 të Konventës (*Josipović kundër Serbisë* (vendim), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

23. Për sa më sipër, është e drejtë që çështja të hiqet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë anonime,

Mban në konsideratë kushtet në deklaratën e Qeverisë së paditur sipas neneve 3 dhe 6 të Konventës, dhe modaliteteve për garantimin e respektimit të premtimeve të bëra në të;

Vendos ta heqë kërkesën nga lista e çështjeve sipas nenit 37§1 (c) të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 9 dhjetor 2021.

Olga Chernishova
ZËVENDËSREGJISTRARE

María Elósegui
KRYETARE